

# PËRGJEGJËSITË TONA NË DEMOKRACI



## DEMOKRACIA NË DUART TONA

RINESA (11), ERDA (10), ALBANA (10), ERBLIN (11), ELMEDINA (10), OLTİ (10), ENDRIT (10),  
ALMİR (10)

# DEMOKRACI!



### Demokracia

Demokracia për ne është liri, respekt, shprehje e lirë, mos diskriminim etj.

Demokracia u paraqit në Greqinë e lashtë shumë vite më parë, më saktësisht në vitin 507 para erës së re. Fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke “demos” që do të thotë popull dhe “kratia” që do të thotë udhëheqje. Demokracia është udhëheqje e popullit.

Përveç disa elementeve që i kemi përmendur më lart, në demokraci ka edhe elemente të tjera. Ndër elementet kryesore të demokracisë janë: të drejtat themelore të njeriut të cilat janë: e drejta për shkollim, e drejta për vendstrehim, e drejta për punësim, e drejta për mjekim, etj.

Ne e kemi kuptuar që demokracia me kaq shumë gjëra të mira që ka, është shumë e rëndësishme dhe e domosdoshme për një shtet.

### Kuvendi i Republikës së Kosovës

Kuvendi është institucioni ku punojnë deputetët. Këta deputetë punojnë në Kuvend falë votave të popullit, të cilat i kanë marrë në zgjedhjet qendrore. Përderisa ata janë duke punuar aty, ata po ashtu kanë edhe detyra për të bërë. Detyrat dhe përgjegjësitë e Kuvendit të Republikës së Kosovës janë: miratimi, shfuqizimi dhe propozimi i ligjeve, mbikëqyrja e punës së Qeverisë, zgjedhja e Qeverisë dhe Presidentit.

Në Kuvendin e Kosovës janë gjithsej 120 deputetë, ku 100 prej tyre janë qytetarët shumicë, pra të kombit shqiptar. Kurse 20 prej tyre janë komunitetet jo shumicë, të cilët janë: romët, ashkalinjtë, boshnjakët, serbët, turqit, goranët dhe egjiptianët.

Në seancat plenare marrin pjesë deputetët, Kryetari dhe pjesëtarët e Qeverisë, të cilët janë: Kryeministri, si dhe ministrat.



Gazetarët gjatë punës



Autorët e artikullit

# PUNO DHE ARRITE NJË QËLLIM

ERDON (10), ANDI (11), EGZON (10), DION (10), JON (10), ERONITA (10), LORINA (11), ERZA (10)

GENTIANA (10)

## Në këtë artikull mund të lexoni për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve

Qytetarët janë banorë të cilët kanë leje qëndrimi në një vend, kurse qytetarët aktiv janë njerëzit të cilët punojnë për ta shndërruar të ardhmen e një vendi.

Ne si qytetarë kemi shumë përgjegjësi dhe ato janë: të ndihmojmë të varfërit, të sigurojmë vendstrehim, të ndihmojmë arsimimin e fëmijëve jetim, të ndihmojmë fëmijët me nevoja të veçanta etj. Pra, në të gjithë botën njerëzit duhet të ndihmojnë njërin-tjetrin. Ne duhet të jemi të sjellshëm, të kemi respekt dhe tolerancë.

Kemi shumë të drejta në demokraci, si për shembull e drejta për ta mbrojtur vendin tonë, e drejta e votimit, e drejta e familjes, e drejta e shoqërisë, e drejta e shkollimit, etj.



Grupi i gazetarëve



E drejta e strehimit



Të ndihmojmë njëri-tjetrin



Bashkëpunimi ynë në grup




Ne jemi e ardhmja

## LLOJET E ZGJEDHJEVE DHE DEMOKRACIA

ARIAN (10), EDON (10), ENDRIT (10), DRINOR (11), BLERTON (10), DRENUSHA (10), RINESA B. (10)

MEDINA (10)



### Ne jemi nxënës të klasës V-1 dhe dëshirojmë t'iu tregojmë për gjërat që kemi mësuar mbi demokracinë dhe zgjedhjet

Demokracia është pjesë e çdo shteti. Ajo lindi shumë shumë vite më parë, në vitin 507 para lindjes së Krishtit, që i bie se demokracia është 2500 vite (25 shekuj) e vjetër. Demokracia lindi në Athinë të Greqisë, e pastaj u përhap në tërë botën. Kemi dy lloje të demokracisë: demokracinë direkte dhe demokracinë përfaqësuese. Tek demokracia direkte qytetarët e një populli takohen që të marrin një vendim të përbashkët për jetën e tyre. Pra, të gjithë veprojnë së bashku duke votuar. Kurse te demokracia përfaqësuese, populli voton për përfaqësuesit apo deputetët, të cilët punojnë në Kuvend. Demokracinë përfaqësuese e krijojmë ne njerëzit, duke votuar të pëlqyerit apo personat e duhur për pozitën e


deputetit në Kuvend.

Zgjedhje quajmë procesin demokratik, ku ne votojmë. Ne në Kosovë kemi dy lloje të zgjedhjeve. Ato janë zgjedhjet parlamentare dhe zgjedhjet komunale. Në zgjedhjet komunale ne votojmë për kryetarin e komunës dhe asamblenë komunale. Ndërsa, në zgjedhjet parlamentare qytetarët i japin votat dhe votojnë kandidatët e preferuar për deputetë. Kuvendi i Kosovës i ka 120 deputetë, të cilët zgjedhin Presidentin e Kosovës, Kryetarin e Kuvendit si dhe Qeverinë e Kosovës. Detyra e deputetëve është miratimi i ligjeve tona.


Ne mendojmë se zgjedhjet janë shumë të rëndësishme, sepse përmes tyre ne vendosim për të ardhmen e Kosovës dhe për të ardhmen tonë. Kur të rritemi edhe ne dëshirojmë të marrim pjesë në të gjitha zgjedhjet në Kosovë, si ato parlamentare dhe komunale.




Grupi i trefë i gazetarëve



Pema e Demokracisë




Zgjedhjet në demokraci




Ne kemi të drejtën e shprehjes së mendimit në grup



Kujdesi ynë ndaj njëri-tjetrit



Drejhtësia, element i rëndësishëm në demokraci



Deputetët në Kuvend



Kuvendi ka funksion kontrollues



Ne punojmë së bashku



Ne jemi të lumtur në demokraci



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Hilmi Rakovica“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-1  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë